



REPUBLIKA E SHQIPERISE
INSTITUTI I MONUMENTEVE TE KULTURES

“Gani Strazimiri”

DOKUMENTET E ANKANDIT PUBLIK PER SHITJEN E
AUTOMJETEVE TE TEPERTA TE IMK

Tabela e Përmbajtjes

1. NJOFTIMI I ANKANDIT dhe FTESA PER OFERTE.....	
2. UDHËZIME PËR ZHVILLIMIN E ANKANDIT.....	
3. UDHËZIME PËR KANDIDATET BLERËS.....	
4. PJESMARRJA DHE KUALIFIKIMI.....	
5. VLERËSIMI I OFERTAVE DHE ZHVILLIMI I ANKANDIT.....	
6. NËNSHKRIMI I KONTRATËS.....	
7. SHTOJCAT	

NJOFTIMI I ANKANDIT

1. **Autoriteti shitës:** Instituti i Monumenteve te Kultures “Gani Strazimiri”
2. **Data e zhvillimit te ankandit:** 24.04.2014, Ora 10.00
3. **Lloji i Procedurës standarde te ankandit :** E Hapur
4. **Objekti i Shitjes:** Shitja e automjeteve të tepërta të IMK
5. **Vendi i zhvillimit te ankandit:** Instituti i Monumenteve te Kultures, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme, Rr.A. Moisiu (ish kinostudio), nr.76 Tirane
6. **Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje:** Dt.24.04.2014, ora 10.00
7. **Informacion mbi dokumentet e ankandit:** Instituti i Monumenteve te Kultures, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme

Dokumentet e ankandit mund te terhiqen pranë autoritetit shites

Dokumente me pagesë:

Po X Jo ☐

Nëse Po

Monedha Lek Çmimi 300

Dokumentet e ankandit përbëhen nga:

- Formulari i njoftimit;
 - Ftesa per oferte;
 - Udhëzimet per zhvillimin e ankandit
 - Formulari i njoftimit te fituesit;
 - Shtojcat
 - Procesverbali/et i/e Komisionit te Ankandit.
8. **Kërkesa për pjesëmarrje, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatët blerës në kopje fizike, me postë ose dorazi, në vendin e përcaktuar në dokumentet e ankandit**

FTESA PËR OFERTË

Seksioni I Autoriteti Shitës

I.1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri Instituti i Monumenteve te Kultures
Adresa Rr.”A. Moisiu (ish kinostudio)”, nr.76, Tiranë
Tel/Fax 0454152/3
E-mail stelahaxhiu @gmail.com

I.2 Emri dhe adresa e personit përgjegjës:

Emri Stela Haxhiu
Adresa Rr. “A.Moisiu (ish kinostudio)”, nr.76, Tirane
Tel/Fax 0454152/3
E-mail stelahaxhiu@gmail.com
Adresa e internetit kultura.gov.al

I.3 Lloji i autoritetit shites dhe aktiviteti ose aktivitetet kryesore:

Institucion qëndror	Institucion i pavarur
☒	☐
Njësiti e qeverisjes vendore	Tjetër
☐	☐
Shoqëri tregtare	Ndërmarrje shtetërore
☐	☐

Seksioni II Objekti i ankandit publik

II.1 Shitja

Objekte	Shërbime	Mallra
☐	☐	☒

II.2 Përshkrim i shkurtër i objektit te shitjes

1. Vlera fillestare 125.000 leke

2. (Qellimi i shitjes, sasite) **Shitja e automjetit te tepert te institucionit, cope 1**

II.3 Vendndodhja e objektit te shitjes:

Prane Godines se IMK.

II.4 Ndarja në LOTE:

Po ☐ Jo ☒

Nëse po,

II.5 Përshkrim i shkurtër i loteve

(Sasia ose synimi dhe vlera fillestare e LOTEVE e shprehur ne Lek)

Seksioni III Procedura

IV.1 Lloji i procedurës:

E hapur	Me përzgjedhje të blerësve	Me negociim
☒	☐	☐

IV.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) çmimi më i lartë

Informacione të mëtejshme në dokumentat e ankandit publik

IV.3 Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: **24.04.2014** , Ora: **10.00**

Vendi: IMK, Tirane

IV.4 Periudha e vlefshmërisë së ofertave: 100 dite (e shprehur në ditë)

IV.5 Gjuha (-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Shqip	☒	Anglisht	☐
Tjetër	_____		

Seksioni IV Informacione plotësuese

V.1 Dokumente me pagesë:

	Po	X	Jo	☐
<i>Nëse Po</i>	Monedha	Lek	Çmimi	300

V.3 Publikime të mëparshme, lidhur me të njëjtin objekt shitje (nëse zbatohet):

Data _____ Numri _____

V.4 Informacione shtesë (vendi, zyra, mënyrat për tërheqjen e dokumenteve të ankandit)

Instituti i Monumenteve te Kultures, Drejtoria e Sherbimeve te Brendshme.

Dokumentacioni përkatës i automjetit që do të shitet, do të jetë në dispozicion për çdo ofertues, në faqen zyrtare të Ministrisë së Kulturës.

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi: 24.03.2014

2. UDHEZIMET PËR ZHVILLIMIN E ANKANDIT

1. Procedura e ankandit publik do të kryhet në përputhje me Ligjin nr. 10160, datë 15.10.2009, “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë”, VKM Nr. Nr.1242, datë 16.12.2009, “Për rregullat e funksionimit të komisionit të ankandit, procedurat e zhvillimit të ankandit, kriteret e vlerësimit të pronës, që nxirret në ankand, si dhe për mënyrën e indeksimit të përfitimit financiar mujor”.
2. Çdo Kandidatë blerës ftohet të dorëzojë ofertë. Kontrata e shitjes do t’i akordohet atij Kandidatë blerës që ofron çmimin më të lartë gjatë zhvillimit të procedurës së ankandit publik.
3. Autoriteti shitës lejohet që, në çdo kohë, të anulojë ankandin, për arsye të interesit publik, duke respektuar parimet e barazisë dhe të transparencës. Autoriteti shitës në asnjë rast nuk është i detyruar të shpallë fituesin për një ankand.
 - a. Autoriteti shitës nuk mban asnjë përgjegjësi ndaj ofertuesve, që kanë paraqitur oferta, për vendimin e marrë në bazë të pikës 1 të këtij neni. Autoriteti shitës boton njoftimin për anulimin e ankandit brenda 10 ditëve nga marrja e vendimit për anulim.
 - b. Të gjithë të interesuarit që kanë dorëzuar një ofertë ose kanë marrë pjesë në procedurë do të njoftohen për vendimin e marrë dhe arsyet për anulimin e procedurës së ankandit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e këtij vendimi.
4. Autoriteti shitës, në çdo kohë, përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave të ankandit dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë për sqarim nga një kandidat, mund të bëjë ndryshime në dokumentet e ankandit, përmes hartimit të një shtojce. Çdo shtojcë u komunikohet menjëherë të gjithë kandidatëve blerës, që kanë tërhequr dokumentet e ankandit dhe bëhet detyruese për ta. Shtojca vihet në dispozicion edhe në rrugë elektronike. Në çdo rast, autoriteti shitës e zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me të paktën 5 ditë.

3 UDHËZIME PËR KANDIDATET BLERËS

Mënyrat e komunikimit me ofertuesit

- 3.1 I gjithë komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit (korrespondenca) ndërmjet Autoritetit Shitës dhe Kandidatëve blerës duhet të bëhet me shkrim.
- 3.2.1 Do të konsiderohet se korrespondenca është dorëzuar në kohën e duhur, nëse përmbajtja e saj, me shkrim, ka mbërritur tek Autoriteti Shites para skadimit të afatit kohor.

Hartimi i ofertës

- 3.3 Kandidatët blerës janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DA. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DA do të refuzohen si të papranueshme.
- 3.4 Kandidatët blerës përballojnë kostot që lidhen me përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës së tij. Autoriteti shitës nuk është përgjegjës për këto kosto.
- 3.5 Oferta dhe të gjithë dokumentet e korrespondenca që lidhet me ofertën, e shkëmbyer ndërmjet Kandidatit blerës dhe Autoritetit shitës duhet të përgatiten në gjuhën shqip.
- 3.6 *(opcion).*

Një takim sqarues do të organizohet me dt. 10.04.2014, në mënyrë të tillë që Kandidatët blerës të mund të familjarizohen me DA, automjetet dhe kërkesat e saj. Pjesëmarrja është fakultative, por Kandidati i interesuar Blerës duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. **Në këtë kërkesë Kandidati Blerës duhet të japë të dhënat personale identifikuese si dhe të dhënat e Kartës së identitetit.** Gjatë takimit do t'u jepen informacione shtesë e shpjegime, të cilat do tu shpërndahen të gjithë Kandidatëve blerës. Të gjitha kostot e Kandidatëve blerës që lidhen me takimin duhet të mbulohen nga vetë ata.

Për të organizuar takimin ju lutem kontaktoni: (z. Stela Haxhiu, shih të dhënat e mësipërme të personit të kontaktit)

- 3.7 Origjinali i ofertës duhet të shtypet ose të shkruhet me bojë që nuk fshihet. Të gjitha fletët e ofertës duhet të lidhen së bashku dhe të numerizohen. Të gjitha fletët e ofertës, përveç literaturës së pandryshueshme e të printuar duhet të pajisen me initiale ose të nënshkruhen nga Personi (-at) e autorizuar, i cili duhet të përcaktojë edhe adresën e qartë si dhe çdo të dhënë tjetër të kontaktit.

Në rast të ofertave të paraqitura nga një bashkim operatorësh ekonomik/ ose personash, oferta duhet të shoqërohet me Prokurën/autorizimin me Shkrim të noterizuar për Personat e Autorizuar që do të përfaqësojnë bashkimin gjatë procedurës së ankandit (Prokura mund të përfshijë edhe autorizimin për të nënshkruar një kontratë).

- 3.8 **Oferta duhet të përfshijë dokumentet e mëposhtme:**

- a) Formularin e Ofertës, në përputhje me modelin e bashkangjitur si Shtojca 1 në DA
- b) Dokumentet dhe vërtetimet e përmendura në Seksionin 4 të DA.

Fshehtësia

- 3.9 Autoriteti shitës nuk do të bëjë publik informacionet e marra nga kandidatët blerës ose ofertuesit, të etiketuar si konfidenciale. Ky lloj informacioni përfshin veçanërisht aspektet teknike, sekretet tregtare dhe informacionet konfidenciale të ofertave.
- 3.10 Kandidatet blerës duhet të dorëzojnë vetëm ofertën origjinale të futur në një zarf jotransparent, të mbyllur, të vulosur (nëse është operator ekonomik) dhe të firmosur me emrin dhe adresën saktë të Ofertuesit dhe të shënuar: **“Ofertë për blerjen e _____;**
“MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËN
KOMISIONI I ANKANDIT, DHE JO PARA _____ (dd/mm/vv) _____orës”.

Llogaritja e çmimit

- 3.11 Kandidati blerës duhet të plotësojë Formularin e Ofertës bashkangjitur me këto DA, duke përcaktuar çmimin për lotin përkatës, që përbën çmimin e plotë.
- 3.12 Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në Monedhën Shqiptare (Lek).
- 3.13 Afati kohor dhe vendi për dorëzimin e ofertave është dt. 24.04.2014, ora 10.00, pranë Zyrës së Protokollit (nëse dërgohet me postë) ose para Komisionit të Ankandit.
- 3.14 Ofertat duhet të dorëzohen në adresën e mëposhtme:
Instituti i Monumenteve të Kultures “Gani Strazimiri”, Rr. A. Moisiu, nr.76 Tirane. Komisioni i Ankandit për shitjen e automjeteve të tepërta ose në Zyrën e Protokollit duke saktësuar subjektin të cilit i adresohet “Komisioni i Ankandit për shitjen e automjeteve të tepërta”.
- 3.15 Afati kohor për dorëzimin e ofertave skadon më **dt.24.04.2014, në ora 10.00.**

Ofertat e paraqitura pas skadimit të afatit kohor do t'i rikthehen të pahapura Kandidateve blerës përkatës.

Data dhe vendi për hapjen e ofertave

- 3.16 Hapja publike e ofertave do të kryhet ne momentin e fillimit te ankandit publik
Më dt. 24.04.2014 në ora 10.00, në IMK, Sektori i Finances dhe Shërbimeve te Mbeshtetese.

Ofertuesit ose përfaqësuesit e tyre mund të jetë të pranishëm në hapjen e ofertave. Informacioni që komunikohet gjatë hapjes publike të ofertave duhet t'i komunikohet të gjithë Kandidateve blerës të pranishëm.

Periudha e Vlefshmërisë së Ofertës

- 3.17 Ofertat duhet të jenë të vlefshme për 100 (ditë) që nga momenti i skadimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave. Periudha e vlefshmërisë së ofertës fillon që nga momenti i skadimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave.
- 3.18 Komisioni i Ankandit, sipas kërkesës, pajis ofertuesit me një dëshmi ku shënohen data dhe ora e pranimi të ofertës.

4. DOKUMENTET QË DUHET TË PARAQITEN

- 4.1 Kandidatet blerës duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kërkesën me shkrim;
- b) vërtetimin nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit (nëse është operator ekonomik);
- c) në rastin e personave fizik dokumenti origjinal i identifikimit një kopje e të cilit depozitohet pranë komisionit të ankandit

5. VLERËSIMI I OFERTAVE DHE ZHVILLIMI I ANKANDIT

1. Komisioni, pas mbarimit të afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose pas mbarimit të afatit përfundimtar të përcaktuar, pas zgjatjes së këtij afati, në përputhje me njoftimet përkatëse, i hap të gjitha ofertat në datën, vendin dhe kohën e përcaktuar në dokumentet e ankandit.
 2. Ofertuesit ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar, që kanë paraqitur oferta, ftohen të marrin pjesë në hapjen e ofertave.
 3. Emri, adresa e ofertuesit, oferta e të cilit hapet, si dhe çmimi i çdo oferte lexohen me zë të lartë për ata persona, që janë të pranishëm, dhe regjistrohen në procesverbalin e procedurës së ankandit.
 4. Procesverbali duhet t'i vihet menjëherë në dispozicion, në bazë të kërkesës, çdo ofertuesi, ndërsa ofertuesi që ka paraqitur ofertën, por që nuk është i pranishëm ose i përfaqësuar në hapjen e ofertave, duhet t'i dërgohet për njoftim.
5. Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese:
- a. Ofertat renditen, duke filluar me çmimet më të larta dhe deri në ato të barabarta me çmimin fillestar minimal të shitjes.
 - b. Komisioni përcakton ofertën më të mirë, pas krahasimit dhe vlerësimit të ofertave ,dhe shpall fitues ofertuesin, oferta e të cilit ka vlerën më të lartë.
 - c. Në rast se pas hapjes së ofertave rezultojnë dy ose më shumë oferta me vlerë të barabartë, fituesi shpallet me short.

Ndalimi i negociatave

- 5.1 Nuk do të kryhet asnjë negociatë me Ofertuesin në lidhje me ofertën e tij.

Megjithatë, Autoriteti shites mund t'i kërkojë Ofertuesit të sqarojë ofertën e tij, pa bërë asnjë ndryshim në thelbin e saj.

Korrigjimi i gabimeve dhe pjesët e hequra

- 5.2 Autoriteti Shitës korrigjon ato gabime në ofertë, që janë thjesht të një natyre aritmetike, nëse gabimi zbulohet gjatë shqyrtimit të ofertave.

5.3 Gabimet në llogaritjen e çmimit do të korrigjohen nga Autoriteti Shties, sipas shembujve të mëposhtme:

- në rast se ka mospërputhje ndërmjet shumave të shprehura në shifra dhe atyre në fjalë, atëherë do të mbizotërojnë shumat e shprehura në fjalë, me përjashtim të rasteve kur shuma në fjalë lidhet me një gabim aritmetik,

- Nëse ofertuesi nuk i pranon ato, atëherë oferta e tij do të refuzohet.

5.4 Autoriteti Shitës e konsideron një ofertë si të pranueshme, nëse ajo i plotëson kërkesat e parashikuara në njoftimin e kontratës dhe në DA. Pavarësisht nga sa u tha më lart, Autoriteti Shitës ka të drejtë ta quajë ofertën të pranueshme, nëse:

(i) ajo përmban ndonjë gabim ose pakujdesi që mund të korrigjohen pa ndryshuar asnjë kusht ose aspekt material të kësaj oferte, ose që nuk ndikojnë në konkurrencë, ose

(ii) ajo përmban vetëm devijime të vogla që nuk e ndryshojnë materialisht ose që nuk lindin si pasojë e karakteristikave, kushteve dhe kërkesave të tjera të paraqitura në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e ankandit; megjithatë, me kusht që çdo ndryshim i tillë të matet sa më mirë të jetë e mundur, dhe të merret në konsideratë siç duhet gjatë vlerësimit dhe krahasimit të ofertave.

5.5 Sa herë që refuzohet një ofertë ose s'kualifikohet një ofertues, autoriteti shitës informon ofertuesin e interesuar mbi arsyen/t e skualifikimit ose refuzimit. Formulari i njoftimit gjendet në Shtojcën 6 të DA.

6. NËNSHKRIMI I KONTRATËS

6.1 Njoftimi i fituesit i jepet menjëherë ofertuesit, që ka paraqitur ofertën më të mirë.

6.2 Autoriteti shitës dhe ofertuesi fitues nënshkruajnë kontratën brenda **10 ditëve nga njoftimi i fituesit** Kjo periudhë nuk duhet të tejkalojë afatin e vlefshmërisë së ofertës, të përcaktuar në njoftimin e ankandit ose në dokumentet e ankandit.

6.3 Kontrata hyn në fuqi kur nënshkruhet nga fituesi i ankandit dhe nga autoriteti shitës në përputhje me dispozitat e Kodit Civil.

6.4 Kontrata e shitjes hartohet në përputhje me Kodin Civil.

6.5 Autoriteti Shitës do të firmosë me Fituesin e ankandit te shpallur nga Komisioni i Ankandit.

7. SHTOJCAT

Shtojcat e mëposhtme janë pjesë përbërëse e DA:

Shtojca 1: Kërkesa për pjesmarrje (Formulari i Ofertës)

Shtojca 2: Kriteret për Pjesmarrje dhe vlerësim të ofertës

Shtojca 3 Njoftimi Standard për Ofertuesin e Skualifikuar

Shtojca 4: Formulari i Fituesit

Shtojca 5: Specifikimet Teknike

Shtojca 6: Sasia dhe Grafiku i Lëvrimit

Shtojca 1.

**KËRKESA PËR PJESMARRJE
(FORMULARI I OFERTËS)**

1. EMRI I OFERTUESIT _____
(Emer, Mbiemer, Nr. Kartë Identiteti/ Pasaportë)

2. ADRESA _____

3. EMERTIMI I AUTOMJETIT QE KERKON TE BLEJE _____

4. OFERTA (ne leke) _____
(me shifra dhe me fjale)

Nenshkrimi _____
(emer, mbiemer, firme)

Shtojca 2.

1. KRITERET PËR PJESËMARRJE DHE VLERËSIM TË OFERTËS

Autoriteti shitës kualifikon në procedurat e ankandit çdo kandidat ose ofertues vetëm kur paraqet:

- a) Këkesën për pjesmarrje;
- b) vërtetimin nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit (nëse është operator ekonomik). Këto kritere duhet te vërtetohen përmes dokumentave të lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertës.
- c) në rastin e personave fizik dokumenti origjinal i identifikimit një kopje e te cilit depozitohet pranë komisionit të ankandit

2. Autoriteti shitës, kur kërkohet informacion për ofertuesin rezident në një shtet të huaj, mund të kërkojë bashkëpunimin e autoriteteve përkatëse.

Skualifikimi i ofertuesve

A. Autoriteti shitës skualifikon në çdo kohë kandidatët ose ofertuesit, që paraqesin të dhëna të rreme ose një dokument të falsifikuar, gjatë një procedure ankandi.

B. Oferta e paraqitur është nën vlerën fillestare të ankandit.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 3.

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[vendi dhe data]

[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të ankandit publik. Procedura e kryer në përputhje me ligjit nr.10160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe civilë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1242, datë 16.12.2009 “Për rregullat e funksionimit të komisionit të ankandit, procedurat e zhvillimit të ankandit, kriteret e vlerësimit të pronës, që nxirret në ankand, si dhe mënyrën e indeksimit të përfitimit financiar mujor”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u [s’kualifikuat] [eliminuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme [shënoni kutinë e duhur]:

[subjekti juaj] [drejtuesi juaj ekzekutiv]

- ☐ mori pjesë në përgatitjen e njoftimit të kontratës, ose dosjen e ankandit, ose pjesë të tij, që u përdorën nga autoriteti kontraktor
 - ☐ mori asistencë të paligjshme në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së ankandit, ose një pjesë të saj
-

[subjekti juaj]

- ☐ Është gjykuar nga një gjykatë që gëzon juridiksionin kompetent se ka kryer një shkelje kriminale ose civile, që përfshin praktikën korruptive, pastrimin e parave, organizimin kriminal ose aktivitetet e përshkruara në Nenin 15 të LAP, në ligjet ose rregullat e zbatueshme në Shqipëri, ose sipas marrëveshjeve dhe konventave ndërkombëtare;
- ☐ Një gjykatë me juridiksion kompetent ka vendosur se ka kryer një veprim mashtrimi ose një veprim të njëvlershëm me mashtrimin;
- ☐ Është dënuar nga një gjykatë me juridiksion kompetent, për sjellje të gabuar profesionale;
- ☐ Është në ndjekje penale për një nga veprat penale të përshkruara në nenin 15 të LPP;
- ☐ ka falimentuar, aktiviteti është marrë nën administrimin e gjykatës,
- ☐ është nën procedurën e deklarimit të falimentimit, sipas një urdhri për likuidim të detyruar ose administrim nga gjykata, ose sipas një marrëveshjeje me kreditorët, ose sipas procedurave të ngjashme;
- ☐ është dënuar me vendim të formës së prerë për shkelje lidhur me sjelljen profesionale;
- ☐ nuk ka paguar kontributet e sigurimit shoqëror, në përputhje me Ligjin Shqiptar dhe dispozitat në fuqi në shtetin e origjinës;
- ☐ nuk ka përbushur detyrimet lidhur me pagimin e tatimeve, në përputhje me Ligjin Shqiptar ose me dispozitat në fuqi në shtetin e origjinës;

Nuk arritët të paraqisni:

- ☐ Certifikatat ose vërtetimet e kërkuara që tregojnë se ju nuk jeni në kushtet e Nenit 45 të LPP,
- ☐ Një certifikatë, dokument ose vërtetime të tjera të mjaftueshme që kërkohen nga autoriteti shites sipas Nenit 46 të LPP dhe (*seksionet përkatëse të DT*), me qëllim verifikimin e përshtatshmërisë suaj profesionale;
- ☐ Autoriteti Kontraktor ka vendosur se ju keni dorëzuar dokumente që përmbajnë informacion të rremë ose dokumenta të falsifikuar, me qëllim kualifikimi;
- ☐ Oferta juaj [nuk i përgjigjet kërkesave] [është e parregullt] [është anomalisht e ulët];
- ☐ Nuk arritët të plotësonit kërkesat për sigurimin e ofertës;

☐ (ndonjë shkak tjetër përvec atyre më sipër)

JUSTIFIKIMI

[Jeni s'kualifikuar] [oferta juaj u refuzua] për shkak të këtyre arsyeve, si më poshtë:

[Shënoni arsyet e hollësishme për s'kualifikimin ose refuzimin e ofertës në fjalë]

Nëse mendoni se Autoriteti Shitës ka shkelur LAP ose RAP gjatë procedurës së ankandit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LAP dhe seksionin 6 të DT.

Edhe pse nuk mundëm të bashkëpunonim në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të shitjeve nëpërmjet ankandit publik.

Me respekt

< **Emri** >

Shtojca 4

[Autoriteti Shites]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Ref. ...]

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

* * *

Procedura e ankandit: [Referenca e dosjes nga autoriteti kontraktor]

Përshkrim i shkurtër i procedurës së ankandit dhe objektit të tij: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Njoftojme se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____ Vlera _____
Emri i plotë i shoqërisë / Individit (me numra dhe fjale)

2. _____ Vlera _____
Emri i plotë i shoqërisë / Individit (me numra dhe fjale)

Etj. _____

Jane skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë / Individit

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë / Individit

Perkatesisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *[emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]* se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej *[shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]* është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* për të nënshkruar kontratën e blerjes, siç parashikohet në dokumentat e ankandit, brenda _____ (____) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

* * *

[Drejtuesi i autoritetit shitës]

Shtojca 5.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

NR.	TARGA	MARK A	MODELI	NR SHASISE	Vit Pro dh	lloji I karbur antit	NGJYRA	Nr. vend eve	Vlera fillestare e Ankandit
1	BG 561SD	BENZ	220	WDB2021341A769958	1995	nafte	gri	4+1	125 000

Shih proces verbalin per automjetin ne dokumentacionin bashkangjitur.

Shtojca 6

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që shitet:

Shitet 1 (nje) automjet.

Afatet e lëvrimit:

Me kryerjen e pageses ne llogarine bankare te autoritetit shites.